

POLITIKA PËR ZHVILLIMIN E SKEMAVE TË REJA TË AKREDITIMIT

DAK-PO-08

APROVUAR NGA,
DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Irfan LIPOVICA

PËRMBAJTJA

1. FUSHA	3
2. REFERENCAT	3
3. PËRGJEGJËSITË	3
4. FJALORI DHE SHKURTESAT	3
4.1 Fjalori	3
4.2 Shkurtesat	3
5. PËRSHKRIMI I POLITIKËS	3
5.1 Kërkesë për një skemë të re të akreditimit	3
5.2 Studimi i fizibilitetit	4
5.3 Vendimi për fillimin e një skeme të re të akreditimit.....	5
5.4 Vlerësimi i një skeme të vlerësimit të konformitetit sipas një skeme ekzistuese të akreditimit.....	5
5.5 Ndërprerja e një skeme të akreditimit	6
6. ANEKSET	6
7. REGJISTRAT	6
8. HISTORIA	6

1. FUSHA

Kjo politikë përshkruan procesin që duhet ndjekur nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit e Kosovës (DAK) kur hartohet një skemë e re e akreditimit ose një skemë e re e vlerësimit të konformitetit sipas një skeme ekzistuese të akreditimit.

2. REFERENCAT

- Ligji nr. 05/l-117 për Akreditimin;
- ISO/IEC 17011:2017 - Vlerësimi i konformitetit - Kërkesat për trupat e akreditimit që akreditojnë trupat për vlerësim të konformitetit;
- Rregullore (MTI) nr. 02/2018 për Këshillin Profesional;
- [EA-1/22 A:2023 \(Procedura e EA dhe kriteret për vlerësimin e skemave të vlerësimit të konformitetit nga anëtarët e trupit akreditues të EA-së\)](#)

3. PËRGJEGJËSITË

Kjo politikë është e detyrueshme dhe zbatohet për të gjithë personelin e brendshëm të DAK-së, anëtarët e KP dhe KT-të.

4. FJALORI DHE SHKURTESAT

4.1 Fjalori

Për qëllimin e kësaj Politike zbatohen termat dhe përkufizimet e dhëna në standardin ISO/IEC 17011:2017.

4.2 Shkurtesat

EA	European Accreditation (Bashkëpunimi Evropian për Akreditim)
IAF	International Accreditation Forum (Forumi Ndërkombëtar i Akreditimit)
DAK	Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit e Kosovës
DP	Drejtor i Përgjithshëm
MC	Menaxher i Cilësisë
KP	Këshilli Profesional
KA	Këshilli i Akreditimit
KT	Komitetet Teknike

5. PËRSHKRIMI I POLITIKËS

5.1 Kërkesë për një skemë të re të akreditimit

Zhvillimi i një skeme të re të akreditimit me qëllim të zgjerimit të aktiviteteve të DAK-së mund të iniciohet nga DAK ose nga ndonjë nga akterët, si p.sh:

- a) Qeveria
- b) Rregullatorët
- c) Komitetet Teknike
- d) Industritë

Në momentin që DAK fillon me zhvillimin e një skeme të re të akreditimit ose pas pranimit të një kërkesë të tillë, DP informon Këshillin Profesional, në mënyrë që të marrë mbështetje për zhvillimin e politikave të reja lidhur me operimin dhe zgjerimin e aktiviteteve të DAK-së në nivele kombëtare dhe ndërkombëtare në përputhje me nenin 4 (1.4 dhe 1.5) të Rregullores (MTI) nr. 02/2018 për Këshillin Profesional.

DP i kërkon MC-së, që në bashkëpunim me DDAZH, të iniciojnë një projekt për zhvillimin e skemës së re të akreditimit dhe më pas të menaxhojnë zbatimin e skemës. MC fton KP-në, stafin e brendshëm të DAK-së, anëtarët përkatës të KT-ve, palët e interesuara dhe ekspertët e jashtëm për të marrë pjesë në ekipin e projektit.

5.2 Studimi i fizibilitetit

Projekti kryen një studim të fizibilitetit, duke adresuar, ndër të tjera, të mëposhtmet. Studimi i fizibilitetit regjistrohet në programin e Aktivitetit (në formularin PO-08-F01).

a) Deklarimi i problemit

Kjo përfshin deklarimin e arsyeve dhe nevojës për akreditim dhe një hetim dhe identifikim të një dështimi ekonomik ose tregu që duhet të adresohet nga skema. Informacionet duhet të sigurohen mbi natyrën dhe madhësinë e problemit.

b) Deklarimi i objektivave të dëshiruara

Objekti i skemës së re të akreditimit duhet të specifikohet. Objekti nuk duhet të specifikohet në atë mënyrë që të përafrohet me (dhe kështu të justifikojë paraprakisht) efektet e veçanta të skemës së propozuar. Në vend të kësaj, i njëjti duhet të specifikohet në raport me problemin themelor.

c) Analiza e mjedisit rregullator

Ky seksion duhet të identifikojë politikën para-ekzistuese dhe autoritetin e politikave (nëse ka) për një iniciativë të mundshme rregullatore. Duhet të identifikohen akterët e industrisë, përfshirë qeverinë dhe institucionet rregullatore të përfshira në industrinë.

d) Analiza e industrisë

Ky seksion duhet të paraqesë të gjitha dinamikat e njohura të industrisë që mund të ndikojnë ose të prekin skemën e re të akreditimit në raport me rrezikun e paanshmërisë. Kjo mund të përfshijë madhësinë e industrisë, strukturën, shtrirjen gjeografike dhe disponueshmërinë e aftësive të kërkuara dhe efektin e politikës së paanshmërisë.

e) Kërkesat e burimeve

- Të përcaktohet skema e kërkuar e akreditimit (d.m.th. akreditimi i trupave të certifikimit të produktit në përputhje me ISO/IEC 17065, etj.)
- Të vendosen kriteret e kompetencës për rekrutimin e personelit, duke marrë në konsideratë dokumentet përkatëse të EA, ILAC dhe IAF.
- Të analizohet stafi ekzistues i DAK-së (të brendshëm dhe të jashtëm) dhe kompetencat e tyre.
- Të përcaktohen nevojat për përmirësim (përfshirë trajnimet), nevoja për rekrutimin e stafit kompetent (përfshirë stafin e jashtëm).
- Të përcaktohet disponueshmëria e dokumenteve të kërkuara, siç janë standardet kombëtare/regjionale/ndërkombëtare, kërkesat e rregullatorit.
- Të përcaktohet disponueshmëria e ekspertëve teknikë për zhvillimin dhe zbatimin e skemës dhe gjithashtu të përcaktohet numri i vlerësuesve të kërkuar për t'i shërbyer industrisë.
- Të përcaktohen kërkesat financiare për ngritjen e skemës. Kjo përfshin koston e rekrutimit, takimet, trajnimin e vlerësuesve dhe kostot e tjera për ngritjen e skemës. Mbi dhe përtej kësaj, një tregues (indikacion) i kostos së parashikuar për zbatimin duhet t'i sigurohet Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë.
- Kërkesat financiare duhet të përfshihen në buxhetin e DAK-së për vitin pasues financiar, nëse nuk janë tashmë të mbuluara nga buxheti aktual.

f) Zbatimi

Rekomandim për aranzhimet e zbatimit.

5.3 Vendimi për fillimin e një skeme të re të akreditimit

DP së bashku me KP, MC dhe DDAZH do të shqyrtojnë studimin e fizibilitetit dhe do të vendosin mbi miratimin e tij. Nëse studimi i fizibiliteti aprovet, DP vendos për aranzhimet e zbatimit, afatin kohor për realizim dhe i bën këto të disponueshme publikisht.

5.4 Vlerësimi i një skeme të vlerësimit të konformitetit sipas një skeme ekzistuese të akreditimit

Aktualisht, DAK nuk ofron akreditim të TVK-ve për ndonjë skemë specifike të vlerësimit të konformitetit.

Në rast se DAK-së i kërkohet nga ndonjë pronar i një skeme të akreditojë TVK-të për një skemë të vlerësimit të konformitetit, atëherë DAK do të vlerësojë përshtatshmërinë e skemës së vlerësimit të konformitetit duke e aplikuar EA-1/22. Për vlerësimin e skemës së vlerësimit të konformitetit, DDAZH krijon një grup punues të përbërë nga palë të interesuara, anëtarë të TC dhe ekspert teknik. Nëse skema e vlerësimit të konformitetit vlerësohet pozitivisht, ajo duhet të implementohet në procedurën e rregullt të akreditimit.

5.5 Ndërprerja e një skeme të akreditimit

Para se DAK të vendosë për ndërprerjen e pjesshme apo të plotë të një skeme të akreditimit, ajo:

- a) konsultohet me palët e interesuara për të kuptuar pikëpamjet e tyre
- b) konsultohet me KP
- c) rishikon detyrat e saj kontraktuale
- d) krijon aranzhime të përkohshme (tranzicionale)
- e) komunikon ndërprerjen tek trupat e lidhur
- f) publikon informacionin mbi ndërprerjen në faqen e saj të internetit.

6. ANEKSET

Programi i Aktivitetit DAK PO-F01

7. REGJISTRAT

Nuk aplikohet

8. HISTORIA

Data e botimit	Përgatitur nga	Përshkrimi i ndryshimeve të aplikuara
26.02.2019	Ardiana Krrabaj	Dokument i ri.
15.11.2019	Valmira Sejdiu	Rishikim i plotë në përputhje me ISO/IEC 17011:2017 dhe DAK-PM-01
25.02.2026	Valmira Sejdiu	Rishikim i pjesshëm në përputhje me ISO/IEC 17011:2017 dhe DAK-PM-01